



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:266860

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591133

AC-I-23-0427

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

Sh K, nga Prizreni i përfaqësuar nga avokati **B I**, Prishtinë.

Kundër

E paditura

NSH "Komuna" (në likuidim), Prizren, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-7255 të datës 17 korrik 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, me shumicë votash lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-7255 të datës 17 korrik 2023, dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ035-0180/34 i datës 30 shtator 2013.**
- 3. Obligohet AKP-Autoriteti i Likuidimit që ti paguaj paditësit në emër të pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor 2005 shumën prej 3,002.00 euro, si dhe shpenzimet e**

përfaqësimit nga ana e avokatit prej 208,00 euro të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 02 korrik 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ35-0180/34 të datës 30 shtator 2013, me të cilën ishte refuzuar kërkesa për pagesën në pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor 2005 në shume prej 3,002.00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Kjo ankesë është regjistruar me numrin C-IV-14-5062.

Me datë 27 nëntor 2014, paditësi së bashku edhe me 92 ish punëtor të tjerë e ka dorëzuar një ankesë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ035-0180/34 të datës 30 shtator 2013. Sipas urdhrorit të Gjykatës paditësi me datë 30 tetor 2013, e dorëzon një ankesë të ndarë, me të cilën ai e konteston vendimin e cekur të Autoritetit të Likuidimit. Lënda regjistrohet me numrin C-IV-14-7255. Lënda e parë me urdhrin e datës 21 mars 2021, bashkohet me lëndën e dytë, dhe vazhdon procedura me numrin C-IV-14-7255. Autoriteti i Likuidimit me vendimin e cekur e kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor 2005 në shumë prej 3,002.00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi i kundërshton këto konstatime të Autoritetit të Likuidimit duke i konsideruar si jo të drejta. Ankuesi pretendon se në rastin e tij nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, dhe rrjedhimisht gabimisht është zbatuar edhe e drejta materiale. Paditësi pretendon se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga ana e AKM-së dhe se ka pranuar njoftimin i cili e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit, andaj nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar, autorizimin e avokatit, njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, njoftimin për fillimin e procedurës së likuidimit, dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 25 janar 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se paditësi ka dështuar të theksoj në ankesë se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se pagat e kërkuara nga paditësi nga muaji janar 2004 e deri në dhjetor 2005 janë të parashkruara, pasi që ai nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi me të cilën do të dëshmonte se i ka kërkuar këto paga para ndonjë Gjykate apo organi tjetër kompetent në afatin prej tri viteve. Andaj me të drejtë Autoriteti i Likuidimit kërkesën e ka refuzuar si të pa vlefshme pasi që ajo ishte parashkruar.

Me datë 26 mars 2021, Gjyqtarja përgjegjëse e lendes, C-IV-14-5062 e lëshon një urdhër për Zyrën e regjistrimit dhe me këtë urdhër e mbyll lenden C-IV-14-5062, ndërsa dosjen e dërgon tek lënda tjetër në pritje C-IV-14-7255, duke konstatuar se është lëndë me e plotësuar, është ushtruar ankesë individuale, vlera, objekti i kontestit dhe vendimi i kundërshtuar është i njëjtë. Në dosjen e kësaj lëndë krahas ankesës janë paraqitur autorizimi i Avokatit, Deklaratë e noterizuar, Njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies se punës, Vendimi e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si dhe kopjen e librezës se punës e mbyllur me 27.03.2007.

Me datë 17 korrik 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-7255 e refuzon si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se kërkesa për paga për periudhën janar 2004 – dhjetor 2005 në shume prej 3,002.00 euro, nuk është e mbështetur me prova të mjaftuara, ndërsa barra e provës bazuar në nenin 42.2 të LDHP dhe nenin 7 të LPK bie mbi paditësin. Kopja e vendimit të kundërshtuar, librezë e punës, njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, si dhe lista e pagave për vitin 2004 nuk e kanë vërtetuar në tërësi kërkesën e tij, andaj në mungesë të dëshmive pretendimet e paditësit për të drejtën e tij në paga nuk janë mbështetur me prova të nevojshme materiale.

Me datë 24 korrik 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-7255, të datës 17 korrik 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit, të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për me tepër në ankesë, paditësi pohon se Shkalla e I-rë në Aktgjykimin e

ankimuar ka përfshirë argumente juridike në dobi të vendimit të Autoritetit të Likuidimit, të cila fare nuk janë përmendur në këtë vendim. Kërkesa për paga është e periudhës janar 2004 - dhjetor 2005 e cila nuk është parashkruar, pasi që Njoftimi i AKP-së për ndërprerje të parashkrimit, i cili është në shkresat e lendes e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit. Duke u bazuar në këtë njoftim paditësi e ka paraqitur kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit. Në ankesë paditësi i referohet një numri të konsideruar të rasteve të Kolegjit të Apelit që i përkasin punëtorëve të se njëjtës NSH. Në ankesë ai ka kërkuar që në bazë të nenit 69 të LDHP-së Kolegji i Apelit të mbajë një seance dëgjimore lidhur me kërkesën e tij me qëllim që të vërtetohet në mënyrë të drejtë baza e ankesës së tij. Bashkë me ankesë ai ka dorëzuar Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies se punës, Kopjen e Librezës së punës, Listën e pagave vjetore të vitit 2004 dhe 2005.

Me datë 04 shtator 2023, AKP-ja e ka dorëzuar në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit duke i konsideruar si të pa bazuar në Ligj dhe e mbështet në tërësi Aktgjykimin e ankimuar, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje AKP-ja në këtë parashtresë ka pohuar se argumentet e saja në mënyrë të mjaftueshme i ka sqaruar në mbrojtje në ankesë të parashtrua pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së , andaj përsëritja këtyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtje të procedurës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar nga Kolegji Apelit që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi së bashku me 119 punëtor tjerë të NSH-së "Komuna" në Prizren me datë 12 maj 2008, e ka paraqitur një kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara për periudhën janar 2004 deri në dhjetor 2005. Kërkesa e paditësit për paga ishte në shumë prej 3,002.00 euro. Kjo kërkesë ishte refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të Nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këtë konstatim të gabuar të Autoritetit të Likuidimit e ka mbështetur edhe Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me rastin e shqyrtimit të ankesës të paraqitur nga paditësi kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ035-0180/34 të datës 30 shtator 2013. Shkalla e I-rë po ashtu konstaton se paditësi nuk ka sjellë prova të mjaftuara në mbështetje të ankesës së tij.

Është e qartë se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, me datë 27 mars 2007, me njoftimin e dërguar nga ish AKM-ja, dhe se ky njoftim e kishte ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Edhe Libreza e punës e dorëzuar si provë në lëndën C-IV-14-5062, e cila lëndë bashkohet me këtë lëndë, vërteton faktin se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune me NSH "Komuna", dhe se atij i është mbyllur Libreza e punës me 27 mars 2007.

Tutje Shkalla e I-rë gabimisht konstaton se paditësi nuk e ka mbështetur me prova të mjaftuara kërkesën e tij lidhur me pagat e pretenduara ndaj NSH-së.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet këto konstatime dhe gjetje faktike të Shkallës së I-rë, pasi që me provat që i kishte dorëzuar në Shkallën e I-rë por edhe me ato të dorëzuara me Shkallën e II-të mjaftueshëm e ka mbështetur ankesën e tij.

Paditësi me ankesën në Shkallën e II-të përveç provave tjera që i kishte sjellur më herët ai sjellë edhe listat e pagave për vitin 2004 dhe 2005, që natyrisht pranohen në këtë fazë të procedurës bazuar në bazë të nenin 70 të LDHP-së.

Kolegji i Apelit konstaton se Njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit dhe ky qëndrim ligjor tashmë është shprehur në shumë raste të mbyllura në jurisprudencën e deri tanishme të Kolegjit të Apelit.

Duke u bazuar në provat e cekura më lartë, paditësit i njihet e drejta në pagat e pa paguara për periudhën janar 2004 – dhjetor 2005, në shumë prej 3,002.00 euro, si dhe bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së edhe e drejta e kompensimit të shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208.00 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se duhet ndryshuar Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, pasi që këto vendime nuk ishin të drejta dhe të bazuara në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 20 euro, me datë 17 gusht 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
